



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/320
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I78-2 Prot.
Nr. Dok. 202503601/2

Tiranë 3/11/2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit në Komisaratin e Policisë në Kolonjë

Drejtuar: Drejtues Madhor Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë

KORÇË

Z. Alket PASHAJ
Shef i Komisariatit të Policisë

KOLONJË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Kolonjë më datë 06.10.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Kolonjë.

Inspektimi u krye sipas Planit Vjetor Inspektimi të MKPT-së të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, mjedise ku mbahen e trajtohen shtetasit që iu është privuar liria, grupi i inspektimit u takua me z. Eneja Cenolli, përgjegjës i seksionit të rendit në Komisaratin e Policisë Kolonjë, i cili u vu në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, z. Cenolli raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e ambientit të shoqërimit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientin e shoqërimit, të gjitha zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo ndaluar.

Në Komisaratin e Policisë Kolonjë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra **nuk** ishin të monitoruara me kamera dhe në këtë organ **nuk** kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera për këqyrjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga këqyrja që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Ky Komisariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale. Të gjitha provat e administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme ndodheshin në këtë ambient.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi për gjetjen e ambienteve të reja deri në rikonstruksionin dhe realizimin e investimeve në Komisarlatin e Policisë Kolonjë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi për vënien në funksion të dhomave të shoqërimit dhe miratimin e këtyre ambienteve në Komisarlatin e Policisë Kolonjë sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurës standarde të miratuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm, dinjitoz, të pajisur me orënditë e nevojshme për qëndrim.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e dhomës së shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kolonjë.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

1. **Ishin marrë masat** nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për nxjerrjen e përgjegjëseve dhe dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë të cilët kanë treguar neglizhencë të theksuar ndër vite në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi respektimin e standardeve të të drejtave të personave të shoqëruar.

¹ Rekomandim nr. K4/I69-2 Prot., datë 25.10.2024 “Rekomandim për inspektimin e bërë në Komisarlatin e Policisë Kolonjë”.

2. **Ishin marrë masat** nga Komisariati i Policisë së Kolonjë për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisarariatit.
3. **Ishin marrë masat** për afishimin të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluar/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat.
4. **Ishin marrë masat** për evidentimin në kartën e të drejtave të afatit maksimal deri në 5 orë të ndalimit të përkohshëm në ambientet policore të shtetasve të shoqëruar.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Avokati i Popullit vlerëson se Komisariati i Policisë Kolonjë është i vendosur në një godinë të vjetër ekzistuese e cila është shumë e amortizuar dhe nuk ofron kushte të denja pune edhe për punonjësit e këtij institucioni çka kërkon domosdoshmërisht realizimin e investimeve për rikonstruksionin e saj në vijim. Nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kolonjë ambientet e shoqërimit **nuk** ishin realizuar plotësisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024, “*Për Policinë e Shtetit*”, dhe procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.²

² Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*” parashikon se: “*Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i*

Në Komisarlatin e Policisë Kolonjë ambientet e shoqërimit ishin përshtatur duke shfrytëzuar si dhomë shoqërimi vetëm një nga ambientet ekzistuese të godinës për meshkujt madhorë, ndërsa gratë dhe të miturit mbaheshin në dhomat e oficerëve të policisë.

Dhoma e shoqërimit ishte e mirëmbajtur për atë sa mund të lejonte infrastruktura e institucionit i cili vit pas viti vinte duke u degraduar. Kjo dhomë ishte e pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolinë e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar dhe kishte një dritare me përmasa të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral. Dritarja nga ana e jashtme ishte e pajisur me zgarë hekuri me shufra vertikale dhe horizontale. Dhoma e shoqërimit kishte ndriçim funksional nga rrjeti elektrik. Gjithashtu realizohej edhe furnizimi me energji elektrike me anë të gjeneratorit në rast defektesh elektrike. Në korridorin e ambientit të shoqërimit kishte një tualet, i cili përdorej nga punonjësit e policisë dhe të shoqëruarit.

Ambienti i shoqërimit në këtë komisarlat **vazhdonte të mos kishte sistem monitorimi me kamera**³ për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit.

Në procedurën standarde të punës është përcaktuar se, të gjitha ambientet e dhomave të shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambienti i brendshëm i dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë. Ndërsa për periudhën janar - tetor 2025 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 100 persona të shoqëruar/ndaluar në mjediset e këtij komisarlati, nga të cilët 4 gra dhe një i mitur.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kolonjë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Korçë.

tyre, si më poshtë : a.Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).

b.Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisarlateve dhe stacioneve të policisë.”.

³ Rekomandim i Avokatit të Popullit për vitin 2023 me shkresën nr. K4/I66-2 prot, dt.19.12.2023, rekomandimi “Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje /intervistimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e këtij komisarlati”.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Kolonjë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 5 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Në këtë komisarariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Gjithashtu, në këtë Komisarariat administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Kolonjë **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë.** Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) në Shqipëri të

kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁴: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin dhe fiksimin e deklarimeve por edhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e vetë punonjësve të policisë së shtetit, ashtu dhe nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Gjithashtu edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde⁵. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në

⁴ electronic recording of police interviews, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

⁵ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

Përgjatë inspektimit në komisariatit e policisë Kolonjë, u konstatua se kishte një listë të avokatëve kryesisht e cila ishte e afishuar në ambientet e komisariatit.

KPT-ja në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e kryer në datat 4-15 maj 2023 ka bërë rekomandime për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohej gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*⁶.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit dhe Bashkinë Kolonjë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe në gjuhë të huaj.

U konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19 paragrafi 5 dhe 25 paragrafi 5 të ligjit nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatit e Policisë Kolonjë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

⁶ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

Gjithashtu, grupi inspektimit konstatoi se karta e të drejtave ju jepej të shoqëruarve/ndaluarve që në momentin e parë të hyrjes në ambientet e Komisarariatit, për të garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë. Në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, përkatësisht në nenin 19 “Ndalimi i përkohshëm”, paragrafi 4, parashikohet ndër të tjera se: *“Personi ndaj të cilit zbatohet ndalimi i përkohshëm policor, ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që kupton për shkaqet e këtij ndalimi, se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar ose avokatin e tij mbrojtës”*.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e ambienteve të reja të shoqërimit deri në realizimin e rikonstruksionit të përgjithshëm të Komisarariatit të Policisë Kolonjë, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për vetë punonjësit e policisë.
2. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm, dinjitoz, të pajisur me orënditë e nevojshme për qëndrim.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e dhomës së shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kolonjë.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
d.v**